



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Nr. ref. 01 /846 / Datë: 06/ 07/ 2018

Senati i Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, në bazë kompetencave të përcaktuara sipas nenit 99 të Statutit të Universitetit, në mbledhjen e mbajtur me 07.05.2018 miratoi propozimet e njësisë akademike për numrin e studentëve që do të pranohen për vitin akademik 2018/19 si dhe vendimit të MASHT-it, nr. 2/2060 të datës 28.06.2018, vendosi për shpalljen e

KONKURSI

për pranimin e studentëve të rinj, në vitin e parë të studimeve themelore - baçelor në vitin akademik 2018/2019

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan, në vitin e parë të studimeve, në afatin e parë të konkursit për vitin akademik 2018/2019, do të regjistrojë **1218** studentë të rregullt në studime baçelor.
2. Mbi numrin e përgjithshëm të studentëve të paraparë si më sipër, Universiteti do të regjistrojë deri në **2%** përkatësisht deri në **22** studentë të rregullt që i takojnë familjes së ngushtë të dëshmorëve (anëtarë të familjes së ngushtë të dëshmorëve janë: bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët). Studentët e kësaj kategorie do të shpërndahen në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
3. Nga numri i përgjithshëm i përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 MASHT-it, Universiteti do të regjistrojë deri në **12 %**, përkatësisht deri **123** studentë të rregullt nga komuniteti jo-shumicë. Kuota prej **12%** të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti jo-shumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
4. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHT dhe Senati, mund të pranohen edhe kandidatët nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja. Numri i studentëve të rregullt që do të pranohen si në paragrafin 1 të pikës I është deri **35** studentë . Kandidatët të cilët kanë lindur në vendet e sipërshënuara, ndërsa shkollimin e mesëm e kanë kryer në ato vende .
5. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga Senati, mund të pranohen edhe kandidatët jashtë Kosovës, përkatësisht **13** studentë të rregullt, për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
6. Universiteti do t'i ketë në konsideratë në mënyrë të veçantë edhe kandidatët me nevoja të veçanta të cilët e kalojnë prapun e provimit pranues.
7. Të drejtë pranimi në Universitetin "Kadri Zeka" kanë të gjithë kandidatët kosovarë, të cilët e kanë përfunduar me sukses shkollën e mesme në Kosovë apo jashtë Kosovës dhe e kanë diplomën për shkollimin e kryer.
8. Kandidatë jo-kosovarë konsiderohen kandidatët të cilët shkollimin e mesëm e kanë mbaruar jashtë Kosovës dhe me rastin e paraqitjes në konkurs, duhet të verifikohet njohja e institucionit shkollor në bazë të listës së MASHT-it e cila iu dorëzohet të gjitha njësisë akademike.
9. Kandidatet te cilet kane diploma jashtë Kosovës duhet ta bëjnë nostrifikimin e tyre në MASHT.
10. Universiteti do të sigurojë përgatitjen e testeve për provim pranues në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin paraprak dhe për të cilën deklarohen paraprakisht në formularin për vetë deklaram.

11. Njësitë akademike përkatëse me rastin e aplikimit të kandidatëve nga komuniteti jo-shumicë bëjnë verifikimin e dokumentacionit pedagogjik duke përfshirë dëftesat dhe diplomat në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin e mesëm.
12. Deklarimi i rrejshëm në formularin për vetë deklaram, sipas nenit 391 të Kodit Penal (KODI NR. 04/L-082) të Republikës së Kosovës konsiderohet vepër penale.
13. Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në kuadër të Universitetit “Kadri Zeka” nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi pa përfunduar studimet në programin ku kanë qenë duke studiuar ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve.
14. Kandidatët për pranim si student në Universitetin “Kadri Zeka” në vitin akademik 2018/19 nuk mund të konkurrojnë më shumë se në një fakultet, departament, drejtim apo program.

II. AFATET E KONKURSIT

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve баçelor, oraret do të jenë si në vijim:

1. Paraqitja e dokumenteve zgjatë prej datës **09.07.2018** deri më **17.07.2018** nga ora 9.00 deri në orën 16.00 (dokumentet do të pranohen çdo ditë me përjashtim të dielave).

Me rastin e paraqitjes, kandidatët duhet t’i sjellin këto dokumente:

- a) *Ekstraktin e lindjes (origjinal),*
- b) *Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme (origjinal, dublikatë ose të noterizuara),*
- c) *Diplomën e kryerjes së shkollës së mesme ose dëftesën e maturës, nëse ka pasur provim të maturës (origjinal ose të noterizuar), për studime баçelor*
- d) *Kopjen e letërnjoftimit,*
- e) *Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit. (vendimi bëhet në MASHT)*
- f) *Fletëparaqitja e plotësuar shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti:*
- g) *Vegza (Linku) për konkurrim online përmes Internetit është: <http://uni-gjilan.net>*
- h) *Pagesën prej 2.5 Euro. Forma e pagesës shkarkohet dhe shtypet nga ueb-faqja e Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan , ndërsa pagesa bëhet në bankë.*

1. Njoftimet dhe oraret për vendin ku do të mbahen provimet pranuese mund të merren në ueb-faqen e universitetit.
2. Provim pranues do të mbahet më **20.07.2018**.
Detajet lidhur me kohën e mbajtjes së provimit pranues sipas njërive akademike do të shpallen në ueb faqen e universitetit më datë 19.07.2018
3. Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet ta posedojnë letërnjoftimin, pa të cilën nuk mund t’i nënshtrohen provimit pranues.
Në kohën e mbajtjes së provimit pranues kandidatët nuk mund të kenë pranë vetes telefona celularë dhe asnjë mjet tjetër teknologjik.
4. Shpallja e rezultateve preliminare të provimit pranues do të bëhet, më së voni, deri më **23.07.2018** në fakultetet përkatëse si dhe në ueb-faqen e universitetit.
5. Shpallja e listës përfundimtare bëhet me datë **27.07.2017**
6. Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve, sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t’i tërheqin deri në diplomim apo çregjistrim nga fakulteti.
7. Në departamentet, degët, drejtimet ose programet ku nuk plotësohet numri i kandidatëve të paraparë me këtë konkurs, do të shpallet konkurs plotësues.
8. Për informata më të hollësishme, kandidatët mund ta vizitojnë faqen e internetit: www.uni-gjilan.net

III. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

- Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet do të bëhet sipas kritereve si në vijim:**
 - Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës:
Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
- **Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë; dhe**
- **Suksesi në provim pranues deri në 70 pikë.**
 - Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës:
Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
- **Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë;**
- **Suksesi në maturë deri në 20 pikë;**
- **Suksesi në provimin pranues deri në 50 pikë.**
- Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.
- Kandidatët të cilët nuk arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.
- Kandidatët nga Lugina e Preshevës, Familjet e dëshmorëve dhe komunitetet, mund të rangohen në listën e të pranuarve nëse kanë arritur së paku 30% të pikëve nga provimi pranues.
- Nëse numri i pikëve të disa kandidatë të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatë tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të provimit pranues, e nëse edhe pikët e provimit pranues janë të njëjta atëherë do të merret parasysh suksesi i shkollës mesme. Në qoftë se edhe suksesi është i njëjtë atëherë përparësi do të kenë kandidatet e gjinisë femërore.
- Regjistrimi i studentëve të pranuar në vitin e parë, bëhet në administratën e njësive akademike, sipas orarit të përcaktuar me këtë konkurs.

IV. E DREJTA E ANKESËS DHE AFATI PËR ANKESË

- Kandidatët të cilët nuk janë pranuar mund t'i paraqesin ankesë fakultetit përkatës më së largu 48 orë pas publikimit të rezultateve. Pas këtij afati, ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave bëhet nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave nga fakulteti përkatës më datë **26.07.2018 duke filluar nga ora 10.00**
- Kandidatët të cilët nuk janë pranuar, mund t'i tërheqin dokumentet e tyre në fakultetin përkatës nga data **24.07.2018** deri më **27.07.2018**

V. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE TË PRANUAR

- Regjistrimi i kandidatëve të pranuar në afatin e parë të regjistrimit do të bëhet në administratën e njësive akademike sipas këtij orari:
 - Të gjitha fakultetet nga data më **10.09.2018** deri më datë **14.09.2018** prej orës 9:00 - 15:00;
- Jashtë këtij afati kandidatët e pranuar nuk do të mund të regjistrohen, prandaj luteni që t'i përmbaheni afatit të lartshënuar.
- Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:**
 - Fletëregjistrimin e plotësuar, i cili merret me rastin e regjistrimit,
 - Dy fotografi (formati 4.5 x 6 cm), të cilat duhet të jenë sipas normave dhe rregullave për dokumente personale.

- c) Studentët shtetas të Republikës së Kosovës që fillojnë studimet në Universitetin “Kadri Zeka”, vitin e parë të studimeve bachelor e kanë falas.
- d) Paga për një semestër për studentë që nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës, do të jetë në lartësi prej 25 € për studime të rregullta, sipas Udhëzimit Administrativ të Masht-it, nr.17/2014 të datës 6.05.2014.
6. Paga bëhet në njërin prej bankave afariste me fletëparaqitje për pagesë, e cila shkarkohet dhe shtypet nga Ueb faqja e Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan.

I. FAKULTETI I EDUKIMIT

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **243** studentë në departamentet si në vijim:

Departamenti - Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga Lugina e Preshevës	Kandidatë nga komunitetet joshumicë	Kandidatë nga Mali i Zi, Shqipëria dhe Maqedonia	Familjet e dëshmorëve	Gjithsej
Gjithsej	200	10	24	4	5	243
FILLOR	120	5	14	2	3	144
PARASHKOLLOR	80	5	10	2	2	99

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e lëmit të ngushtë profesional të degëve mësimore të fakultetit dhe atë:

- **Programi Fillor:** Gjuhë dhe letërsi shqipe, Matematikë dhe Edukatë qytetare
- **Programi Parashkollor:** Gjuhë dhe letërsi shqipe, Matematikë dhe Edukatë qytetare

II. FAKULTETI EKONOMIK

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **590** studentë të rregullt, dhe atë në departamentet si në vijim:

Departamenti- Programi	Për studime të rregullta	Për studime Nga Lugina e Preshevës	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë	Kandidatë nga Mali i Zi, Shqipëria dhe Maqedonia	Familjet e dëshmorëve	Gjithsej
Gjithsej	500	15	60	5	10	590
BANKA, FINANCA DHE KONTABILITET	200	5	24	2	4	235
MENAXHMENT	200	5	24	2	4	235
MARKETING	100	5	12	1	2	120

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e lëmit të ngushtë profesional të departamentit përkatës të fakultetit dhe atë:

- **Fakulteti Ekonomik (Të gjitha drejtimit):** Hyrje në ekonomi dhe Matematikë

III. FAKULTETI JURIDIK

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **292** studentë të rregullt

Departamenti- Programi	Për studime të rregullta	Për studime Nga Lugina e Preshevës	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë	Kandidatë nga Mali i Zi, Shqipëria dhe Maqedonia	Familjet e dëshmorëve	Gjithsej
Gjithsej	250	5	30	2	5	292
JURIDIK	250	5	30	2	5	292

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e fushës së ngushtë profesionale të degës përkatëse të fakultetit dhe atë:
- Fillet e së drejtës, E drejta kushtetuese dhe Edukatë qytetare.

IV. FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **93** studentë të rregullt

Departamenti- Programi	Për studime të rregullta	Për studime Nga Lugina e Preshevës	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë	Kandidatë nga Mali i Zi, Shqipëria dhe Maqedonia	Familjet e dëshmorëve	Gjithsej
Gjithsej	75	5	9	2	2	93
FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE	75	5	9	2	2	93

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët: Matematikë dhe Informatikë.